



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 38.
Prishtinë, më 17.04.2012 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj

Mungon: Lirije Kajtazi.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësueset e OSB-së Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësues të KDI-së Shkumbim Beqiri, përfaqësues të KKK Veton Berisha dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Kordinatore Natasa Prica-Tisma ,zyrtare e lartë e fushës, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, me raportin e Komisionit, funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor me amendamente
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-60 për Mbeturina, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amandamante
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amandamante

7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-106 për Teatrot, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulture, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente**
8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-96 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, me raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**
9. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-82 për Projektkodin Penal, me raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, me amendamente**
10. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-77 për marrëdhëniet e detyrimeve me raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, me amendamente**

***Kryesuesi** - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

***Kryesuesi** – propozoi që rendi i ditës të plotësohem me pikën Projektligjin nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/ L -087 për Ndërmarrjet Publike të komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.*

***Glauk Konjufca** – tha se me ndryshimin e rendit të ditës komisioni duhet të njoftohet paraprakisht për të pasur afat kohor në përgatitjen e çështjeve aktuale.*

***Kryesuesi** - tha se pika me të cilën plotësohet rendi i ditës ka ardhur me vonesë dhe kërkoi që e njëjta të miratohet në komision. Ai konstatoi se rendi i ditës u miratua me shumicë të votave dhe një të përmbajtur.*

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara.

***Kryesuesi** -konstatoi se komisioni njëzëri miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datës 14.03.2012, 21.03.2012 dhe 26.03.2012, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

***Kryesuesi**, theksoi se lidhur me çështjen e procedimit të Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe, komisioni ka pas takimit të përbashkët me të dyja komisionet dhe takim me të dy kryetarët dhe zëvendëskryetarët e komisioneve, dhe se janë paraqit rekomandime konkrete. Ai diskutoi për komisionin tonë se ka mbet kontestuese vetëm interpretimi i disa neneve, gjegjësisht amendamenti 4 i pozuar nga Qeveria.*

Më pas e informoi komisionin se Qeveria ka tërheq propozimin e vet lidhur me amendamentin 4. Njëherit kërkoi që komisioni të deklarohej për cilin version do të votohet.

***Petar Miletic** –Sa i përket shqyrtimit të Projektligjit për Fshatin Hoçë e Madhe dhe amendamentet e komisionit funksional, si komision jemi akorduar për miratimin e shumicës së tyre.*

Me theks të veçantë tha se komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar në tërësi amendamentet e propozuara nga Qeveria.

Konsideron se grupi SLS nuk pajtohet me amendamentin 4, të propozuar nga komisioni funksional, ku bëhet fjalë për çështjen e themelimit të Këshillit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

***Glauk Konjufca** – tha se grupi jonë parlamentar gjatë shqyrtimit të Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe ka shprehur qëndrimet e veta. Me këtë projektligj politizohet çështja e bashkëjetesës së komuniteteve të Kosovës.*

Konsideron se Projektligj rrjedh drejtpërdrejt nga Plani i Ahtisarit si edhe shumë ligje tjera . Sa i përket obligimeve të planit të Ahtisarit në veçanti ju përkasin subjekteve të cilët kanë votuar këtë plan. Më pas shtoi se programi politik të cilin ai e përfaqëson është luftimi kundër planit të Ahtisarit. Konsideron se ky projektligj është i kontestueshëm dhe do të votojë kundër miratimit të tij. Njëherit propozoi që komisioni të votojë veçmas amendamentet e komisionit Funksional dhe në veçanti Projektligjin si tërësi.

Elmi Reçica – Me theks të veçant tha se Projektligji për Hoçën e Madhe do të procedohet si të gjitha ligjet tjera të cilat rrjedhin nga Plani i Ahtisarit. Ai ceku se realisht, të gjithë jemi pajtuar me përgjegjësitë që rrjedhin nga Plani i Ahtisarit, nga se janë detyra obliguese jo vetëm të Qeverinë por përgjegjësi e të gjitha institucioneve Kosovare, që të miratohen ligjet në pako. Ai bëri ftesë që Projektligji të kalojë në të gjitha procedurat parlamentare dhe të votohet në Kuvend.

Kryesuesi – pajtohet me parafolësin se jemi të obliguar të miratohen të gjitha ligjet që rrjedhin nga plani i Ahtisarit dhe se të njëjtat të procedohen për miratim në Kuvend. Ai kërkoi që komisioni të votojë veçmas amendamentet e komisionit funksional dhe në veçanti Projektligjin.

Petar Piletic – Ai propozoi që komisioni të miratojë neni 4. të propozuar nga Qeveria, me këtë këtë përbërje:

3. Këshilli përbëhet nga pesë anëtarëve: 3.1 dy anëtarë të zgjedhën nga Kuvendi i Komunës, 3.2 dy anëtarë të zgjedhën drejtpërdrejtë nga qytetarët e fshatit Hoçë e Madhe dhe 3.3 një anëtarë nga Kisha Ortodokse.

Ai propozoi që komisioni të miratojë Projektligjin për Fshatin Hoçë e Madhe për Kuvend me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi – kërkoi që komisioni të deklarohet për votim në tri propozimet:

a) propozimi për miratim të tekstit të Projektligjit në tërësi, b) propozimin për amendamentet e Komisionit Funksional, dhe c) propozimin e tekstit të punuar nga Qeveria.

Pas rezultateve të votimit me nëntë (9) për, një (1) kundër (deputetit Glauk Konjufca) dhe një (1) abstenim (deputetit Xhevdet Neziraj), Komisioni nxori këtë :

Përfundim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe kthim ka miratuarr Projektligji nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe me raportin e amendamenteve të komisionit funksional, përveç amendamentit 4.
- II. Komisioni propozoi që neni 4 të mbetet si në projektligj.
- III. Komisioni për Komunitete dhe Kthim miratoi Projektligjin nr. 04/L-62 për Hoçë të Madhe në tërësi

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, me raportin e Komisionit, funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.

Kryesuesi, Kryesuesi paraqet për shqyrtim raportin me amendamente në Projektligjin nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, të propozuara nga Komisioni funksional

Në diskutimin e tij tha se vullneti i të gjitha subjekteve politik është që të miratohet Projektligji për fshatin Hoçë e Madhe dhe Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit.

Sa i përket shqyrtimit të Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit është dhënë kontribut i duhur si nga ana e komisionit funksional ashtu edhe nga Bashkësia Evropiane. Njëherit kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim apo vërejtje konkrete.

Petar Miletic- sa i përket Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit është çështje e ndjeshme dhe se gjatë shqyrtimit janë reflektuar polemika të ndryshme. Projektligji ka të bëjë me pronën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Qendrës së Prizrenit, andaj me këtë ligj do të rruhet diverziteti i karakterit urban dhe tradicional. E saktë është se projektligji rrjedh nga Plani i Ahtisarit dhe se aprovimi i tij e obligon Qeverinë e Kosovës.

Ai ceku se si grup parlamentar kemi qen konstruktiv në miratimin e shumicës së amendamenteve të komisionit funksional. Ndërsa për ne janë të papranueshme amendamenti 11 dhe 19, të propozuara nga deputeti Nait Hasani.

Kur bëhet fjalë për përbërjen, kemi propozuar amendamentin që fjala komitet të mbetet këshill. Pra propozoi që amendamentit 11 të mbetet si në Projektligj.

Ai shtoi se është i papranueshëm propozim amendamenti 19, me tekstin, që në shtesën II të fshihet shkolla e mesme ortodokse. Me këtë propozim cenohen të drejtat e komuniteteve.

Ai deklarohet për miratimin e projektligjit me propozim amendamentet e cekura më lartë.

Glauk Konjufca- Sa i përket projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit ekzistojnë dy probleme, njëri është se projektligj i përket kategorisë së paqenë nga se në rast kur do të krijohet ndonjë kontest në institucione, disa komunitete fetar nuk do të kenë përfaqësuesin e tyre i cili i arbitron çështjet kontestuese përbrenda zonës historike të Prizrenit.

Kur bëhet fjalë për respektimin e konventave ndërkombëtare me këtë ligj në të ardhmen do të paraqiten probleme të shumta, prandaj ligji si i tillë është diskriminues. Ai deklarohet se do të jetë kundër votimit të projektligjit në tërësi.

Kryesuesi - propozoi që të votohen veçmas amendamentet e komisionit Funksional dhe në veçanti amendamentet e Qeverisë.

Pas rezultateve të votimit me nëntë (9) për, një (1) kundër (deputetit Glauk Konjufca) dhe një (1) abstenim (deputetit Xhevdet Neziraj), Komisioni nxori këtë :

Përfundim

- I. Komisioni ka shqyrtuar amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional dhe të njëjtat janë përkrah, përveç amendamentit 11 dhe 19, me dy vota për, dy abstenim dhe shtatë kundër .
- II. Komisioni shqyrtoi edhe amendamentet e Qeverisë dhe të njëjtat u përkrahën me shumicë të votave.
- III. Komisioni për Komunitete dhe Kthim miratoi Projektligjin nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit dhe rekomandon Kuvendit për miratim me propozimet e cekura më lartë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-60 për Mbeturina, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-60 për Mbeturina, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-60 për Mbeturina dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-106 për Teatrot, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-106 për Teatrot, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Kryesuesi konstatoi se me rezultat të votimit me dhjetë vota për, një abstenim, Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-106 për Teatrot dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-96 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, me raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-96 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Kryesuesi konstatoi se me rezultat të votimit me dhjetë vota për, një abstenim, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-96 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-82 për Projektkodin Penal, me raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-82 për Projektkodin Penal, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-82 për Projektkodin Penal dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-77 për marrëdhëniet e detyrimeve me raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-77 për marrëdhëniet e detyrimeve, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-77 për marrëdhëniet e detyrimeve dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

11. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/ L - 087 për Ndërmarrjet Publike, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/ L -087 për Ndërmarrjet Publike, dhe kërkoj që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit FunkSIONAL.

Kryesuesi konstatoi se me rezultat të votimit me nëntë (9) vota për një(1) të abstenim dhe një (1) kundër, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/ L -087 për Ndërmarrjet Publike dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit

Te ndryshme

Xhevdet Neziraj – Përsëhendeti anëtarët e komisionit duke shprehur qëndrimin se do të ofrojë përvijën e tij shumëvjeçare. Mendon se mirë është që në mbledhje të komisionit të jenë prezent përfaqësuesit e zyrës së Kryeministrit, të Ministrisë për KK, dhe përfaqësuesit e KKK, për faktin kur diskutohen çështjet e komuniteteve jo shumicë.

Pajtohet se duhet të procedohen projektligjet që rrjedhin nga Plani i Ahtisarit por në suaza që të respektohen të drejtat e komuniteteve tjera.

Theksoi se me Ligjin për promovimin e të drejtave të Komuniteteve është e rregulluar çështja e punësimit edhe të komunitetit egjiptian. Në pyetjen e përfaqësimit të komunitetin egjiptian në ndërmarrjet Publike, siç është KEK-u, PTK-ja nuk janë plotësuar standardet sipas ligjeve që janë në fuqi andaj këto janë arsye të mos votimit të projektligjeve në fjalë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic